



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.41/2018
Prishtinë, më 2.10.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Hykmete Bajrami, Memli Krasniqi, Liburn Aliu, Muharrem Nitaj, Veton Berisha dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Glauk Konjufca dhe Mimoza Kusari-Lila, anëtarë.

I ftuar: Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës.

Pjesëmarrës tjerë: Eset Berisha, Nebih Shatri, Argjend Zenaj, MI; Halit Hoxhaj, Luan Morina, MZHE; Qerkin Berisha, EUTA; Nora Kukaj, Ambasada Britanike; Bleronë Hoxha, Diellza Luzha, KDI; Dren Ajeti, Klubi i Prodhuesve Kosovarë; Emine Shehu, “Ekonomia Online”; Arta Dehari dhe Vatra Qehaja, GP/ LV; Shpresë Sejdiu, GP/ PSD.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

- 1.Miratimi i rendit të ditës;
- 2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 18.9.2018;
- 3.Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-109 për ratifikimin e Traktatit që themelon Komunitetin e Transportit;
- 4.Shqyrtimi i raportit me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-079 për Eficiencë të energjisë;
- 5.Shqyrtimi i raportit me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete;
- 6.Te ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.9.2018

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 18.9.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-109 për ratifikimin e Traktatit që themelon Komunitetin e Transportit

Kryetarja, tha se lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, e kemi të ftuar z. Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës, të cilit ia dha fjalën, për të e paraqitur në parim Projektligjin për ratifikimin e Traktatit që themelon Komunitetin e Transportit.

Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës, tha se çështja kryesore e trajtuar në këtë projektligj, është ratifikimi i Traktatit të Komunitetit të Transportit në mes të BE-së dhe shteteve të Evropës Juglindore. Traktati që themelon komunitetin e transportit është nënshkruar më 12 korrik 2017, në Trieste të Italisë, në mes të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian. Me projektligjin për ratifikimin e Traktatit të Komunitetit të Transportit në mes të BE-së dhe shteteve të Evropës Juglindore, synohet hyrja në fuqi e këtij traktati. Qëllimi i këtij traktati është krijimi i një komuniteti të transportit, në fushën e transportit rrugor, hekurudhor, ujqor të brendshëm dhe detar, si dhe zhvillimi i rrjetit të transportit të Bashkimit Evropian dhe palëve të Evropës Juglindore. Komuniteti i Transportit bazohet në integrimin e tregut të transportit të palëve të Evropës Juglindore në tregun e Bashkimit Evropian, mbi bazën e kuadrit ligjor përkatës të *aquis*, duke përfshirë dhe sferën e standardeve teknike, ndër-funksionimin, sigurinë, politikën sociale, menaxhimin e trafikut, e çështje të tjera, të ndërlidhura me transportin. Nëpërmes këtij traktati, synohet prioriteti kryesor - krijimi i një tregu të integruar për infrastrukturën dhe transportin tokësor, transportin detar dhe rrugëve ujore (transportin lumor) dhe të harmonizojë legjislacionin përkatës në rajonin e Ballkanit me legjislacionin e BE-së, në mënyrë që të mundësojë përdoruesve të transportit dhe publikut të gjerë, për të përfituar sa më shpejt nga avantazhet e anëtarësimit. Ky Traktat i Komunitetit të Transportit, për vendin tonë, por edhe vendet e rajonit, do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin sa me të shpejtë të një rajoni, që ka potenciale të jashtëzakonshme ekonomike, duke siguruar një nxitje më të madhe të rritjes së qëndrueshme ekonomike dhe rivitalizimin e rrjeteve hekurudhore. Gjithashtu, do të lejojë rrjetin tonë trans-evropian të transportit, të zgjerohet dhe të kontribuojë në zhvillimin e mëtejshëm të tregut tonë të brendshëm. Krejt në fund, tha se qëllimi i ratifikimit të këtij projektligji është që Kosova të vulosë ligjërisht, përmes Kuvendit, për të qenë pjesë e Komunitetit të Transportit dhe me këtë të bëjë edhe një hap në rrugën tonë të integritimit evropian.

Kryetarja potencoi se është e rëndësishme për Kosovën dhe qytetarët e saj, fuqizimi dhe prezenca e Kosovës, duke qenë të integruar në organizatën e Traktatit, që themelon Komunitetin e Transportit. Andaj, si të tillë, ju ftoj që ta votojmë për miratim në Kuvend.

Pas debatit, komisioni, me 6 (gjashtë) vota për dhe 2 (dy) abstenim, nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet Projektligji nr. 06/L-109 për ratifikimin e Traktatit që themelon Komunitetin e Transportit;*
- 2. I rekomandohet Kuvendit, të miratojë me 2/3 Projektligjin nr. 06/L-109 për ratifikimin e Traktatit që themelon Komunitetin e Transportit;*
- 3. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet deputetja, Sala Berisha- Shala, kryetare e komisionit.*

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-079 për Eficiencë të energjisë

Kryetarja, tha se grupi i punës e ka përfunduar amendamentimin e Projektligjit për Eficiencë të energjisë dhe ka bërë një punë shumë të mirë, me të gjitha palët që ka punuar, pastaj fjalën ia dha kryesuesit të grupit të punës, z. Dardan Sejdiut, për të paraqitur raportin me amendamente të projektligjit.

Dardan Sejdiu, tha se grupi i punës, së bashku me të gjitha palët e interesit, siç është Zyra e Komisionit Evropian, Ministria për Zhvillim Ekonomik dhe nga shoqëria civile, siç janë INDEP, bashkë me KOSID, kanë dhënë kontribut me opinionet e tyre, për ta bërë sa më funksional Projektligjin për Eficiencë të energjisë. Grupi i punës ka nxjerrë 39 amendamente që janë hartuar nga projektligji. E vetmja dilemë që ka qenë, është ajo për Fondin për Eficiencë të Energjisë, sesi do të funksionojë gjatë zbatimit të ligjit dhe për këtë çështje kemi kërkuar sqarime nga ministria, ku i kemi marrë sqarimet e nevojshme, me anë të shkresave. Po ashtu, theksoi se e mira e këtij ligji është edhe themelimi i Fondit për Eficiencë të Energjisë, fond ky që do të mbushet nga donatorët, fillimisht, mjete këto që do të përdoren për renovimin, fillimisht të ndërtesave publike, si spitale, shkolla e kopshte fëmijësh, por edhe për projekte tjera të ngjashme. Më tej, propozoi që të gjitha amendamentet të votohen në pako, pasi që nuk ka diçka kontestuese dhe iu kanë dërguar më herët deputetëve.

Memli Krasniqi, tha se miratimi i Projektligjit për Eficiencë të energjisë është i rëndësishëm, për ta proceduar sa më shpejt për miratim në seancë, pasi që kemi të bëjmë më përfitim e donacioneve të shumta që janë për të mirën e shumë institucioneve publike siç u cekë. Po ashtu është i harmonizuar dhe më direktivat e BE-së.

Hykmete Bajrami, shprehu shqetësimin lidhur më Fondin për Eficiencën të Energjisë, pasi që varet prej vullnetit të donatorëve do të ishte më mirë të jetë si Fondi për Garanci Kreditore, sepse komplet është i pavarur, prandaj edhe funksion mirë. Ndërsa, me Ligjin për eficiencë të energjisë, nuk garantohet pavarësia e tillë, kur dihet se përgjegjëse për të është vetëm MZHE-ja. Ajo tha se për këtë arsye, abstenon për këtë projektligj.

Dardan Sejdiu, sqaroi se donatorët kryesorë janë: Bashkimi Evropian dhe Banka Botërore, edhe ekspertët e fushës janë dakord me mënyrën e organizimit të qeverisjes së fondit. Kemi ardhur në një situatë, ku kemi bërë përmirësime të mjaftueshme, ku edhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe palë tjera të interesuara, e kanë mirëpritur dhe përshëndetur krijimin e këtij Fondi për Eficiencën e Energjisë.

Liburn Aliu, tha se rëndësinë e Projektligjit për Eficiencë të energjisë e kemi të qartë, por brenga është sesi do të funksionojë fondi. Pra, kjo lë hapësirë për shqetësim, sesi do të ketë zbatim në praktikë.

Kryetarja kërkoi nga anëtarët e komisionit, që të mos bëhen pengesë për procedurë të mëtutjeshme, pasi që edhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, është interesuar se në cilën fazë është projektligji. Sigurisht, i kemi dilemat tona, por sidoqoftë kërkoj që të votohet. Dilema ime është te përfaqësuesi i asociacionit të komunave, sesi do të përfaqësohen në Bordin e Drejtorëve.

Dardan Sejdiu, propozoi që të gjitha amendamentet të votohen në pako, pasi që nuk ka diçka kontestuese.

Propozimi i z. Dardan Sejdiut, që amendamentet të votohen në pako, u përkrah nga komisioni.

Pas debatit, komisioni, me 6 (gjashtë) vota për dhe 2 (dy) abstenim, nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 06/L-079 për Eficiencë të energjisë;

2. Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 06/L-079 për Eficiencë të energjisë, procedohet në komisionet e përhershme për vlerësim, sipas kompetencës.

Këtij procesverbali i bashkëngjitet Raporti me amendamente.

5.Shqyrtimi i raportit me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete

Kryetarja, tha se, po ashtu, edhe për këtë pikë të rendit të ditës, grupi i punës e ka përfunduar amendamentimin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Automjete. Kryesues i grupit të punës është z. Muharrem Nitaj, të cilit ia dha fjalën, për të paraqitur raportin me amendamente.

Muharrem Nitaj, prezantoi raportin me amendamente, për ndryshimin dhe plotësimin e Projektligjit për Automjete, duke i arsyetuar amendamentet një nga një. Më tej, tha se grupi i punës ka pasur disa takime për amendamentimin e projektligjit, por gjatë shqyrtimit ka pasur propozime, që të ndryshohen edhe nene të caktuara të ligjit bazik, prandaj është dashur të kemi

një kujdes më të shtuar gjatë punës në grupin punues. Po ashtu, e njoftoi komisionin se për amendamentin nr.1 (një), nuk ka pasur pajtim të plotë në grupin e punës, ndërsa për amendamentet tjera po. Te amendamenti nr. 1, neni 2, kemi qenë të kujdesshëm me lëvizjen e kufirit, duke e pasur parasysh situatën sociale dhe ekonomike të qytetarëve, lëvizja e limitit deri në 15 vjet, është bërë për ta gjetur një mes, sepse ka qenë edhe kërkesë e qytetarëve, se nuk mund të blejnë vetura më të reja se 10 vjet. Amendamenti 2, neni 63, ndryshon ndërrimin e pronarit, se është i mundur vetëm nëse në të njëjtën kohë regjistrohet edhe pronari i ri i mjetit në evidencë. Z. Nitaj, tha se ligji bazik ka shkelje të rënda, ku pronarët detyrohen që kur e blejnë veturën, edhe nëse ka regjistrim, ai detyrohet që veturën ta regjistrojë prej fillimit, nga e para. Amendamenti 3, kemi amendamentin e z. Lutfi Zharku dhe e kemi përkrahur. Ai theksoi se ky ndryshim ka mundësuar të hiqet kufiri i kontroleve teknike në një komunë dhe mund të bëhet brenda Republikës së Kosovës, ku ka subjekte për kontroll teknik. Ndërsa, nuk e kemi përkrahur amendamentin tjetër të z. Zharku, që të fshihet paragrafi 3 i nenit 89 të ligjit bazik, por e kemi riformuluar nenin 4, të propozuar për të qartësuar ligjin.

Hykmete Bajrami, tha se edhe lejimi i veturave të vjetra rrit koston e mirëmbajtës, nëse jemi për t'i mbrojtur interesat e qytetarëve, atëherë mund të heqim taksën që paguhet më së shtrëngti në rajon, për ta regjistruar një automjet. Ajo tha se për çështjen e lirimit të regjistrimit të automjeteve, kemi mundur që përmes homologimit, ta bëjmë të mundur te liberalizimi i tregut. Pastaj, çmimi kishte mundur të jetë më i lirë, kur dihet që kemi monopol në tregut me një qendër të vetme të regjistrimit të automjeteve. Më tej, kërkoi që të ftohet ministri Lekaj, që të raportojë për këtë çështje.

Memli Krasniqi, theksoi se dëmet që po u shkakton qytetarëve të Kosovës, është ligji në fuqi, nëse blihet një veturë, nëse një muaj përpara e ka bërë regjistrimin, pronari i ri duhet ta bëjë përsëri edhe një herë regjistrimin e automjetit. Prandaj, e kemi për të detyrë t'i marrim parasysh interesat e të gjithëve dhe qytetarëve.

Liburn Aliu, tha se është kundër kësaj zgjidhjeje për amendamentin nr.1, sepse kufiri i caktuar është i dëmshëm për qytetarët, për shkak të kushteve ekonomike që u cekën, konsideroi që duhet të rriten mekanizmat e cilësisë së kontrollit të automjeteve dhe vendosja e kufizimit për të gjetur zgjidhje të mesme përmes viteve 10-15, nuk është zgjedhje e duhur. Prandaj, jam kundër këtij amendamenti.

Dardan Sejdiu, po ashtu, është shprehur kundër amendamentit 1, sepse kemi statistika të shumta që vjetërsia e veturave ndikon në aksidente me fatalitet. Sa më shumë e rrisim vjetërsinë e veturave, aq më shumë ka aksidente me fatalitet. Jam dakord me dy amendamente të tjera, por për amendamentin 1, jam kundër kategorikisht, për çështje sigurie.

Pas debatit, komisioni, me 5 (pesë) vota për dhe 2 (dy) kundër, nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete;

2. Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 06/L-027 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete, procedohet në komisionet e përhershme, për vlerësim, sipas kompetencës;

Këtij procesverbali i bashkëngjitet Raporti me amendamente.

6. Të ndryshme

Çështjet vijuese.

Kryetarja i njoftoi anëtarët e komisionit për dy çështje që do të shqyrtohen nga komisioni, si: formimi i grupit për zgjedhjen e Bordit të KOSTT-it dhe informata, lidhur me shkeljet e dispozitave të Ligjit për komunikime elektronike, nga anëtari i Bordit të ARKEP-it.

Komisioni përkrahu propozimin e kryetares.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Për: Komisionet e përhershme të Kuvendit të Republikës së Kosovës;

Komisioni për Buxhet dhe Financa;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim;

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit;

Komisioni për Integritet Evropian;

Nga: Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal;

Lënda: Raporti me Amendamente i Projektligjit nr.06/L-079 për Eficiencë të energjisë;

Datë: 2.10.2018, Prishtinë;

Në bazë të nenit 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal, me datë 2.10.2018, e shqyrtoi dhe amendamentoi Projektligjin nr.06/L-079 për Eficiencë të energjisë, dhe, procedon në Komisionet e përhershme për vlerësim sipas kompetencës, si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 1, paragrafi 4, riformulohet si në vijim:

4. Ky Ligj siguron gjithashtu bazën ligjore për transpozimin e legjislacionit që ndërlidhet me kornizën e etikimit të performancës energjetike për produktet e ndërlidhura me energjinë.

Amendamenti 2

Neni 3, nënparagrafi 1.1. fshihet teksti pas pikes “Organe qendrore të administratës shtetërore”.

Amendamenti 3

Neni 3, Pika 1.45 – fjala “izolimi termal” zëvendësohet me fjalën “niveli i komfortit termal”.

Amendamenti 4

Neni 3, nënparagrafi 1.50, riformulohet si në vijim:

1.50. Produkt i lidhur me energjinë ose produkt - do të thotë një mall ose sistem me ndikim në konsumin e energjisë gjatë përdorimit, që vendoset në treg ose futet në shërbim, duke përfshirë pjesët me ndikim në konsumin e energjisë gjatë përdorimit të cilat vendosen në treg ose futen në shërbim për konsumatorë dhe që janë të destinuara që të inkorporohen në produkte.

Amendamenti 5

Neni 3, nënparagrafi 1.51, riformulohet si në vijim:

1.51. Fletëinformacioni i produktit (ose fisha e produktit) - do të thotë një dokument standard që përmban informacion lidhur me një produkt, në formë të shtypur ose elektronike.

Amendamenti 6

Neni 3, nënparagrafi 1.53, riformulohet si në vijim:

1.53. Tregtar - do të thotë një shitës me pakicë ose një person tjetër fizik ose juridik që ofron për shitje, angazhon, ose angazhon blerjen, ose që ekspozon produkte për konsumatorë ose instalues në kuadër të një veprimtarie tregtare, qoftë me pagesë ose pa pagesë.

Amendamenti 7

Neni 3, nënparagrafi 1.54, riformulohet si në vijim:

1.59. Furnizues (i produktit të lidhur me energji) - do të thotë prodhues, përfaqësues i autorizuar i një prodhuesi, ose importues, që vendosë një produkt në tregun e Republikës së Kosovës:

Amendamenti 8

Neni 3, nënparagrafi 1.55, riformulohet si në vijim:

1.55. Vendosja në treg - do të thotë vënia në dispozicion për herë të parë e një produkti në tregun e Republikës së Kosovës

Amendamenti 9

Neni 3, nënparagrafi 1.56, riformulohet si në vijim:

1.56. Futja në shërbim - do të thotë përdorimi i parë i një produkti sipas qëllimit të tij të synuar në tregun e Republikën e Kosovës

Amendamenti 10

Neni 3, pas nënparagrafit 1.56, shtohen edhe katër nënparagraf të ri, si në vijim:

1.57. Grup i produkteve - do të thotë një grup i produkteve të cilat e kanë funksionalitetin kryesorë të njëjtë.

1.58. Etiketë - do të thotë një diagram grafik, qoftë në formë të shtypur apo elektronike, duke përfshirë një shkallëzim të mbyllur që përdorë vetëm shkronja, ku çdo shkronjë paraqet një

klasë dhe secila klasë korrespondon me kursimin e energjisë, me ngjyra të ndryshme, me qëllim që t'i informojë konsumatorët për efikasitetin e energjisë dhe konsumin e energjisë.

1.59. **Dokumentacion teknik** - do të thotë dokumentacion i mjaftueshëm për t'iu mundësuar autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut të vlerësojnë saktësinë e etiketës dhe të fletëinformacionit të një produkti, duke përfshirë raportet e testimeve ose dëshmitë e ngjashme teknike.

1.60. **Vënia në dispozicion në treg** - do të thotë furnizimi i një produkti për shpërndarje apo përdorim në tregun e Republikës së Kosovës në kuadër të një veprimtarie tregtare, qoftë me pagesë apo pa pagesë.

Amendamenti 11

Neni 5, ndryrshohen datat si në vijim; në paragrafin 2, “data 30 qershor 2019” behët “30 prill 2019”; në paragrafin 3, “data 31 dhjetor” behët “30 prill ”; në paragrafin 7, teksti “30 qershor të çdo viti” zëvendësohet me “deri më 30 qershor të çdo viti”.

Amendamenti 12

Neni 5, paragrafi 6, riformulohet si në vijim:

6. Ministria nxjerr akt nënligjor për përcaktimin e kornizës së përgjithshme për PKVEE duke përfshirë edhe kërkesat e raportimit.

Amendamenti 13

Neni 5, paragrafi 8, referenca, “në paragrafin 1.4 të nenit 42” zëvendësohet me “në paragrafin 1.5 të nenit 42”

Amendamenti 14

Neni 6, ndryrshohen datat si në vijim; paragrafi 1, afati “Duke filluar nga 15 maji i vitit 2018” zëvendësohet me “Duke filluar nga 28 shkurt i vitit 2019,”; paragrafi 2, data “30 nëntor” behët “31 mars”.

Amendamenti 15

Neni 7, paragrafi 1, afati “30 qershor 2018”, zëvendësohet me “gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji.”.

Amendamenti 16

Neni 8, paragrafi 6, fjala “paraprake” zëvendësohet me “mëparshme”

Amendamenti 17

Neni 8, paragrafi 7, afati “Deri më 31 Korrik 2018, AKEE,” zëvendësohet me “Deri më 31 Korrik 2019, AKEE,”.

Amendamenti 18

Neni 9, paragrafi 1, fshihet teksti “me kusht që ato janë në përputhje me kosto-efektivitetin, fizibilitetin ekonomik, qëndrueshmërinë e përgjithshme, përshtatshmërinë teknike, si dhe konkurrencën e mjaftueshme.”.

Amendamenti 19

Neni 10, paragrafi 4, referenca “në paragrafin 2 të këtij neni”, zëvendësohet me “në paragrafin 3 të këtij neni”.

Amendamenti 20

Neni 10, paragrafi 7, pas referencës “nenit 42“ shtohet fjalia “të këtij Ligji”.

Amendamenti 21

Neni 10, paragrafi 11, fshihet fjalia e fundit “Kostot e zbatimit, në rast të mosarritjes së caqeve të përcaktuara me skemë, do të shqyrtohen në kuadër të FKEE.”.

Amendamenti 22

Neni 10, paragrafi 13, referenca “paragrafin 8 dhe paragrafët 8.1 dhe 8.2 të këtij neni.” zëvendësohet me “në paragrafin 10 të këtij neni”.

Amendamenti 23

Neni 11, paragrafi 1, fjalia “përmes AKEE ose AKEE” zëvendësohet me “përmes AKEE ose FKEE” si dhe fjalia “nga auditorët e licensuar” zëvendësohen me fjalët “nga auditorët e pavarur të regjistruar në regjistrin e auditorëve të AKEE-së.”

Amendamenti 24

Neni 11, paragrafi 2 dhe 8, fjala “i licensuar” zëvendësohen me fjalën “i regjistruar”.

Amendamenti 25

Neni 11, paragrafi 8, referenca “paragrafin 2.1 të nenit 12 të këtij ligji” zëvendësohet me “paragrafin 4. të nenit 12 të këtij ligji”, dhe kjo vlen për tërë tekstin e projektligjit.

Amendamenti 26

Neni 12, riformulohet si në vijim:

Neni 12

Auditorët e Energjisë dhe Auditimi i Energjisë

1. Auditimi i energjisë kryhet nga auditor i pavarur i energjisë ose një ekip auditorësh, të regjistruar në një regjistër elektronik të përditësuar rregullisht të AKEE-së.

2. AKEE është përgjegjëse për menaxhimin e tërë skemës së auditimit të energjisë, që do të përcaktohet përmes legjislacionit sekondar për auditorët e energjisë dhe auditimin e energjisë, që do të miratohet nga ministri, dhe do të rregullojë së paku si në vijim:

2.1 Kërkesat e trajnimit për kualifikim dhe/ose certifikim ose akreditim të auditorëve të energjisë, duke përfshirë kërkesat dhe mënyrën e mbajtjes së provimeve përfundimtare.

2.2 Metodën dhe procedurat për krijimin dhe mirëmbajtjen e një regjistri elektronik të auditimeve të energjisë dhe auditorëve të energjisë.

2.3 Kërkesat dhe procedurat për regjistrimin e auditorëve të kualifikuar të energjisë në regjistrin elektronik të AKEE-së.

2.4 Kodi i mirësjelljes i auditorëve të energjisë.

2.5 Detyrimet e auditorëve lidhur me raportimin në AKEE.

2.6 Metodën dhe procedurat për kontrollin e cilësisë së raporteve të auditimit të energjisë dhe auditorëve të energjisë, bazuar në kontrollin e një mostre të raporteve të auditimit të energjisë që ata e realizojnë.

2.7 Arsyet dhe procedurat për heqjen nga regjistri i auditorëve për shkak të performancës së dobët dhe/ose shkeljes së kodit të mirësjelljes.

3. Auditimet e energjisë duhet të jenë të cilësisë së lartë, kosto-efektive dhe të kryhen në mënyrë të pavarur nga auditorë të energjisë të kualifikuar dhe të regjistruar që angazhohen për këtë qëllim ose i përkasin personelit të brendshëm, me kusht që të jenë auditorë të regjistruar të energjisë.

4. Me qëllim të garantimit të cilësisë së lartë të auditimeve të energjisë dhe sistemeve të menaxhimit të energjisë, Ministria përcakton kritere minimale transparente dhe jodiskriminuese për auditime të energjisë, në bazë të aktit nënligjor sipas paragrafit 1.6 të nenit 42 të këtij ligji, mbi modelet, udhëzimet dhe dokumentet tjera të nxjerra nga AKEE si dhe kërkesat specifike të cilat mund të nxirren nga institucionet që financojnë/përkrahin investimet relevante në efikasitet të energjisë.

5. Auditimet e energjisë nuk do të përfshijnë dispozita që pengojnë gjetjet e auditimit pas transferimit të një ofruesi të shërbimeve të energjisë, me kusht që klienti/konsumatori të mos ketë vërejtje për këtë.

Amendamenti 27

Neni 16, nënparagrafi 1.1. ndryshohet si vijon:

1.1. matësi ekzistues zëvendësohet;

Amendamenti 28

Neni 17, paragrafi 3, referenca “paragrafin 1.7 nenin 42 paragrafi 1.7 të këtij ligji.” zëvendësohet “nënparagrafin 1.7 të nenit 42 të këtij ligji.”.

Amendamenti 29

Neni 20, nënparagrafi 3.1., fshihet fjala “etike”.

Amendamenti 30

Neni 20, paragrafi 4, fjala “transmisionit” zëvendësohet me “transmetim” dhe kjo vlen për tërë tekstin e projektligjit.

Amendamenti 31

Neni 21, riformulohet si në vijim:

Neni 21

Etiketimi i Energjisë

1. Në bazë të propozimit të Ministrisë përgjegjëse për energji dhe Ministrisë përgjegjëse për tregti, Qeveria e Kosovës miraton akte nënligjore që përcaktojnë një kornizë që zbatohet për produkte të lidhura me energji të vendosura në treg ose të futura në shërbim në territorin e Republikës së Kosovës. Aktet nënligjore duhet të përcaktojnë etiketimin e atyre produkteve dhe sigurimin e informacionit standard lidhur me efikasitetin e energjisë, konsumin e energjisë dhe të burimeve tjera nga produkti gjatë përdorimit dhe informata plotësuese lidhur me produktet, dhe në këtë mënyrë t’iu mundësojnë konsumatorëve të zgjedhin produkte më efikente në mënyrë që të zvogëlojnë konsumin e tyre të energjisë.

2. Në mënyrë që të plotësohen aktet nënligjore sipas paragrafit 1 të këtij neni, Ministria përgjegjëse për energji përcakton kërkesat e hollësishme që kanë të bëjnë me etiketat dhe informacionin për produkte specifike të cilat duhet të jenë në përputhje me këtë ligj.

3. Furnizuesi i produkteve që mbulohen me këtë nen duhet:

3.1 të sigurojë që produktet të cilat janë vendosur në treg janë shoqëruara, për çdo njësi individuale, pa pagesë, me etiketa të sakta të shtypura dhe me fletëinformacion të produktit në përputhje me kërkesat e theksuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

3.2 të sigurojë saktësinë e etiketave dhe fletëinformacionit të produktit që e ofron dhe të hartojë dokumentacion teknik të mjaftueshëm për të mundësuar vlerësimin e saktësisë.

3.3 të veprojë në përputhje me të gjitha kërkesat specifike, siç do të përcaktohen në aktet nënligjore sipas paragrafit 1 të këtij neni.

4. Tregtari i produktit:

4.1 do të shfaqë etiketën e siguruar nga furnizuesi në mënyrë të dukshme, duke përfshirë atë për shitjet në distancë nëpërmjet interneti, por pa u kufizuar vetëm në internet dhe telemarketing.

4.2 do të vë në dispozicion për konsumatorë fletëinformacionin e produktit duke përfshirë, sipas kërkesës, edhe në formë fizike në pikën e shitjes.

4.3 do të veprojë në përputhje me të gjitha kërkesat specifike siç do të përcaktohen në aktet nënligjore sipas paragrafit 1 të këtij neni.

5. Furnizuesi dhe tregtari bashkëpunojë me autoritetin e mbikëqyrjes së tregut dhe marrin masa të menjëhershme për të korrigjuar çdo rast të mos përputhjes me kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe me kërkesat sipas paragrafit 2 të këtij neni, që bien nën përgjegjësinë e tyre, me nismën e tyre ose kur një gjë e tillë kërkohet nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut

6. Ministria përgjegjëse për tregti duhet të jetë autoriteti i mbikëqyrjes së tregut për të siguruar zbatimin e dispozitave të këtij neni.

7. Aktet nënligjore të theksuara në paragrafin 1 të këtij neni përcakton në hollësi si në vijim:

7.1 Çdo kërkesë specifike lidhur me detyrimet e furnizuesve dhe tregtarëve, nëse është e nevojshme.

7.2 Mënyrën e realizimit të aktiviteteve edukative dhe/ose promovuese dhe informuese, siç mund të kërkohen.

7.3 Kërkesat për raportim në lidhje me etiketimin e energjisë.

7.4 Mënyrën e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shkëmbimin e informacionit për mbikëqyrjen dhe kontrollin e tregut.

7.5 Procedurat në nivel kombëtar për trajtimin e produkteve që paraqesin rrezik për mospajtueshmëri me këtë ligj.

7.6 Mënyrën për të ruajtur bashkëpunimin ndërkombëtar lidhur me produktet që konstatohet se nuk janë në pajtueshmëri.

7.7 Mënyrën e përcaktimit të kërkesave të theksuara në paragrafin 2 të këtij neni.

7.8 Dispozita tjera, siç kërkohet.

8. Ministria e Financave, në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, harton një udhëzim administrativ mbi lehtësirat financiare për produktet me efikasitet të lartë të energjisë.

Amendamenti 32

Neni 27, paragrafi 3, ndryshohet si në vijim:

3. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga shtatë (7) anëtarë si në vijim:

3.1 një (1) përfaqësues i emëruar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, si anëtar me të drejtë vote;

3.2 një (1) përfaqësues i emëruar nga Ministria e Financave, si anëtar me të drejtë vote;

3.3 një (1) përfaqësues i emëruar nga Ministria e Administratës Publike, si anëtar me të drejtë vote;

3.4 një (1) përfaqësues i emëruar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës si anëtar me të drejtë vote;

3.5 Drejtori Menaxhues i FKKE si anëtar me të drejtë vote;

3.6 dy (2) anëtarë të pavarur të emëruar nga dy donatorët kryesorë në përputhje me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore dhe rregulloret e brendshme të FKKE, si anëtarë pa të drejtë vote.

Amendamenti 33

Neni 28, nënparagrafi 1.4, referenca “paragrafin 3 dhe 4 të nenit 41 këtij ligji.” zëvendësohet me “paragrafin 4 dhe 5 të nenit 42 këtij ligji.”.

Amendamenti 34

Neni 28, në nënparagrafet 1.5.; 1.6; 1.7; 1.10.; dhe 1.11.; fjala “Aprovon” zëvendësohet me “Miraton”.

Amendamenti 35

Neni 31, paragrafi 2, riformulohet si në vijim:

2. Drejtori Menaxhues i FKKEE duhet të ketë titull universitar në ekonomi, administrim biznesi, inxhinieri apo disiplina të ngjashme që ndërlidhen me veprimtarinë e FKKEE. Drejtori Menaxhues i FKKEE duhet të ketë së paku 5 vite përvojë pune menaxheriale në financa dhe/ose menaxhment. Ai/ajo duhet ta njohë rrjedhshëm gjuhët zyrtare dhe angleze.

Amendamenti 36

Neni 33, paragrafi 4, fshihen inicialet “PMVEE”.

Amendamenti 37

Neni 39, i ndryshohet titulli si në vijim: “Neni 39 Tarifat”.

Amendamenti 38

Neni 41, paragrafi 2, pas referencës “neni 12” i shtohet fjalia “të këtij ligji”.

Amendamenti 39

Neni 43, paragrafi 2, riformulohet si në vijim:

2. Qeveria e Kosovës, përmes Ministrisë, brenda tre (3) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të ndërmarrë të gjitha procedurat e nevojshme për të themeluar Bordin e Drejtorëve të FKKEE në përputhje me nenin 27 të këtij ligji.

Kryetarja e Komisionit,

Sala BERISHA SHALA



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Për: Komisionet e përhershme të Kuvendit të Republikës së Kosovës;

Komisioni për Buxhet dhe Financa;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim;

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit;

Komisioni për Integritet Evropian;

Nga: Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal;

Lënda: Raporti me Amendamente i Projektligjit nr.06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-132 për Automjete;

Datë: 2.10.2018, Prishtinë;

Në bazë të nenit 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal, me datë 2.10.2018, e shqyrtoi dhe amendamentoi Projektligjin nr.06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-132 për Automjete, dhe, procedon në Komisionet e përhershme për vlerësim sipas kompetencës, si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 2, ndryshohet si në vijim:

Neni 44 i Ligjit bazik, paragrafi 2. ndryshohet si në vijim:

2. Në Kosovë nuk mund të importohen vetura më të vjetra se pesëmbdhjetë (15) vjet.

Amendamenti 2

Neni 3, paragrafi 1, ndryshohet si në vijim:

Neni 63 i Ligjit bazik, paragrafi 1. dhe 2. ndryshohen si në vijim:

1. Ndërrimi i pronarit është i mundur vetëm nëse në të njëjtën kohë regjistrohet pronari i ri i mjetit në evidencë.

2. Gjatë bartjes së pronësisë, pronari i ri e regjistron mjetin në emër të tij, në afatin kohor prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e blerjes së mjetit, dhe bartet pjesa e mbetur e regjistrimit të mjetit.

Amendamenti 3, propozim i deputetit Lutfi Zharku, me përkrahje të Komisionit funksional

Neni 4

1. Në nenin 89 i Ligjit bazik, paragrafit 2. fshihet.

Amendamenti 4, dy propozime

A. Propozim i Komisionit funksional

Neni 4

2. Në nenin 89 të Ligjit bazik, paragrafi 3. ndryshohet si në vijim:

3. Kontrolli teknik i mjeteve bëhet vetëm brenda Republikës së Kosovës ku ka subjekte për kontroll teknik.

B. Propozim i deputetit Lutfi Zharku, pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 89 i Ligjit bazik, paragrafi 3. fshihet.

Kryetarja e Komisionit,

Sala BERISHA SHALA